

Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2003-2005

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) mat në mënyrë të vazhdueshme konsumin privat nëpërmjet Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF). Këto statistika janë të nevojshme për të përcaktuar shportën për Indeksin e Çmimeve Konsumuese (IÇK), konsumin privat në Llogaritë Kombëtare (LLK) dhe analizimin e mirëqenies dhe varfërisë. Anketa gjithashtu mat edhe arsimimin, punësimin, kushtet e banimit, pronësinë e mallrave të qëndrueshme, ndërtimin dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me bizneset dhe kultivimin e tokës. Të dhënat janë mbledhur në tërë Kosovën gjatë një viti duke përfshirë 2 400 ekonomi familjare në vit të zgjedhura sipas rastit dhe në pajtim me standardet e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Shkalla e përgjigjeve është më e lartë se 80% nëse ekonomitë familjare të zëvendësuara janë konsideruar se nuk kanë dhënë përgjigje.

Shtator, 2006

Hyrje

Konsumi është pjesë e rëndësishme e jetës së njerëzve. Pasuria dhe varfëria gjithashtu varen nga aspektet tjera në jetë, por niveli i konsumit dhe përmasat e tij janë qenësore për mirëqenien. Përderisa të hyrat fitohen nga individët, konsumi kryesisht ka të bëjë me ekonomitë familjare. Alkooli dhe duhani, veshmbathjet, rekreacioni dhe disa gjëra tjera specifike mund të konsumohen individualisht, por pjesa më e madhe, si ushqimi, banimi dhe furnizimi shfrytëzohen së bashku nga pjesëtarët e ekonomive familjare.

Konsumi klasifikohet sipas standardit të KKIQ-së (Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit) në harmonizim me Llogaritë Kombëtare dhe Indeksin e Çmimeve Konsumuese. Përveç disa përmirësimeve, standarde të njëjta janë aplikuar gjatë viteve, duke e bërë atë të krahasueshëm më lehtë gjatë kohës.

Shumica e konsumit bazohet në mallrat e blera dhe shërbimet e paguara gjatë periudhës së referuar. Periudha e referuar është një muaj për konsumin ditor (të mbështetur me mbajtjen e shënimeve) dhe 12 muajt e fundit për mallrat e qëndrueshme.

Konsumi i përgjithshëm

Konsumi për ekonomi familjare është rritur për rreth 5 % çdo vit duke arritur në 5 800 € në vitin 2005.

Ekonomitë familjare urbane kanë një konsum më të lartë (6 400 €) se ekonomitë familjare rurale me 5 500 €. Rritja gjatë kohës ka qenë e njëjtë në të dy fushat.

Konsumi i përgjithshëm rritet kur ka më shumë arsimim. Ekonomitë familjare ku kryefamiljarët kanë shkollën fillore apo më pak konsumojnë 5 300 €, ndërsa ato më shkollë të mesme konsumojnë 5 800 € dhe ato me arsim të lartë kanë pasur një konsum të përgjithshëm prej 7 700 € në vitin 2005.

Ekonomitë familjare rurale dhe më pak arsim kanë si nivel më të vogël të konsumit ashtu edhe më shumë pjesëtarë për ta ndarë atë.


Duke ju përmbajtur rekomandimeve ndërkombëtare, shpenzimet aktuale për banim nuk janë mbledhur, por vetëm vlera e mirëqenies (qiraja e vendosur) e bazuar në vlerësimin e vetë ekonomisë familjare.

Në këtë dokument ne do të fokusohemi në nivelin e konsumit për grupe të ndryshme konsumuese (ushqim, veshmbathje, banim, etj.) dhe pjesëmarrjen e tyre në konsumin e përgjithshëm. Edhe zhvillimi gjatë kohës për të dy nivelet dhe pjesët do të paraqitet. Ne gjithashtu do t'i krahasojmë disa grupe të ekonomive familjare. Ekonomitë familjare me arsim të lartë dhe ekonomitë familjare urbane mund të shihen si treguese për zhvillimin e ardhshëm të konsumit, pasi që gjithnjë e më shumë njerëzit po arsimohen dhe Kosova është duke u urbanizuar.

Konsumi është ngushtë i lidhur me madhësinë e ekonomisë familjare. Vlera e mirëqenies së konsumit nuk mund të krahasohet ndërmjet grupeve nëse numri i njerëzve që ndajnë konsumin nuk është përfshirë në analiza. Kjo do të bëhet në dokumentin pasues.

Shifrat në tekst janë rrumbullakuar që të sinjalizojnë se një mostër anketë mund t'i japë vetëm vlerat e përafërta.

Figura 1 Konsumi i përgjithshëm vjetor i ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



Ushqimi

Ushqimi paraqet pjesën më të madhe të buxhetit dhe përbën 2 300 € në vitin 2005 apo 39 %. Si konsumi i ushqimit ashtu edhe pjesa e tij e buxhetit janë zvogëluar gjatë kohës. Pjesa ka qenë 47 % në vitin 2003.

Konsumi i ushqimit është pothuajse i njëjtë ndërmjet grupeve më një rritje të vogël për ekonomitë familjare rurale dhe ato më arsim të lartë (2 400 € në vitin 2005).

Pjesa më vogël e buxhetit për ushqimit tregon një mirëqeni më të lartë. Siç është pritur ekonomitë familjare me arsimim të lartë kanë shkallë më të ulët.

Pjesa për ushqim ka ndryshuar ndërmjet 10 dhe 19 % në shtetet anëtare të EU në vitin 1999.

Figura 2 Konsumi vjetor i ushqimit nga ekonomitë familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €





Figura 3 Pjesa për ushqim nga konsumi i përgjithshëm sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, %



Banimi

Banimi përbën pjesën e dytë më të madhe të buxhetit të ekonomive familjare me 1 800 € dhe 31 % të buxhetit. Ushqimi dhe banimi së bashku përbëjnë më shumë se dy të tretat (70 %) të buxhetit.

Ndonëse shumat janë rritur për të gjitha grupet, pjesa e buxhetit ka qenë mjaftë e qëndrueshme gjatë këtyre tri viteve për Kosovën si tërësi dhe për grupet e ndryshme.

Ekonomitë familjare më arsim të lartë kanë vlerat më të larta (2 700 €) të pasuara nga ekonomitë familjare urbane (2 400 €).

Pjesa më e madhe e banimit është “qiraja e vendosur”, dmth. vlera e mirëqenies së shtëpisë. Vetëm pak paguajnë qira.

Pjesa e buxhetit për banim sillet nga 27 % për ekonomitë familjare rurale në 37 % për ato urbane. Në vitin 1999 banimi në shtetet anëtare të BE-së ka ndryshuar nga 20 dhe 31 % in the EU.

Rrobat dhe veshmbathjet

Njëra nga gjërat e para që njerëzit dëshirojnë të shpenzojnë paratë pasi të jenë përkujdesur për ushqim dhe banim janë rrobat. Rrobat nuk janë vetëm mjet për mbrojtje por ato gjithashtu janë një mënyrë që tregon statusin. Pjesa e buxhetit shpesh rritet në fillim të një procesi të zhvillimit, por me vonë është zvogëluar kur ekonomitë familjare duhet të blejnë edhe gjëra.

Shuma dhe pjesa është rritur pak për të gjithë kosovarët dhe më shumë për ata me arsim të lartë.

Një ekonomi familjare mesatare shpenzon 340 € në vit për rroba dhe veshmbathje apo 6 % të buxhetit. Pjesa për buxhet sillet ndërmjet 5 dhe 7 %, krahasuar me 5 – 9 % brenda BE-së në 1999.

Rritja është si pasojë e konsumit më të lartë të rrobave për gra dhe fëmijë.

Figura 4 Konsumi i banimit sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €





Figura 5 Konsumi i rrobave dhe veshmbathjeve sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €




Transporti

Kur njerëzit e përmirësojnë situatën e tyre dhe mund t'ia dalim me ushqim, banim dhe veshmbathje ata zakonisht shpenzojnë më shumë për transport. Transportet janë rritur bukur mirë për të gjitha ekonomitë familjare, por në veçanti për ato me arsimim të lartë.

Pjesa për transporte ndryshon 5 % për ekonomitë familjare urbane në 7 % për ato rurale. Ato me arsimim të lartë gjithashtu shfrytëzojnë 7 % të buxhetit të tyre në transporte..

Në BE në vitin 1999 pjesa e buxhetin ka ndryshuar ndërmjet 10 e 17 %.

Figura 6 Transporti i ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €




Furnizimi

Blerja e mobileve është zvogëluar në vitin 2004, por është rritur në vitin 2005. Një ekonomi familjare mesatare shpenzon 200 € ,ndërsa ato me arsim të lartë shpenzojnë 300 €.

Pjesa e buxhetit ishte 4 % për të gjitha grupet, krahasuar me 5 - 8 % në BE në vitin 1999.

Figura 7 Furnizimi sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €




Konsumi “kryesor”

Pesë kategoritë aktuale të konsumit më të lartë (ushqimi, banimi, rrobat dhe veshmbathjet, transporti dhe furnizimi) paraqesin 86 % të të gjithë konsumit. Ato janë pjesë e nevojshme e konsumit.

Shtatë grupet tjera janë të kufizuara në përqindje më të vogla dhe ndryshimet ndërmjet grupeve të ekonomive familjare janë të vogla.

“Pesëshi i madh” gradualisht po zvogëlohet për të gjitha grupet dhe ekonomitë familjare urbane dhe ato me arsimim të lartë i prijnë këtij zhvillimi.

Figura 8 Pesë kategoritë më të larta të konsumit sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimt, % e përgjithshme



Alkooli dhe duhani

Ky grup konsumues është nënvlerësuar në shumicën e shteteve. Dhe zakonisht janë femrat ato që mbajnë shënime. Konsumi i pjesëtarëve tjerë të ekonomisë familjare mund të harrohet lehtë. Gjithashtu është rrezik që konsumuesi është i turpëruar që t’ju tregojë të tjerëve për shpenzimet e vërteta për duhan the alkool. Një arsye tjetër është se konsumuesit e mëdhenj të alkoolit vështirë se mund të përfshihen në anketë.

Alkooli dhe duhani marrin së paku 4 % të buxhetit të përgjithshëm të ekonomisë familjare apo 229 €. Ky konsum është rritur në vitin 2005. Ndryshimet ndërmjet grupeve janë mjaft të vogla. Në BE ky konsum sillet ndërmjet 2 deri në 7 %. Anketa ka pasur një pyetje shtesë në vitin 2005 dhe në rundin e parë të anketës 2002/2003 është pyetur se sa cigare në ditë një person konsumon. Të gjithë njerëzit së bashku konsumonin 1.6 miliardë cigare në vitin 2005 krahasuar me 2.8 miliardë në vitin 2002/3. Me një çmim prej 0.5 € për paqetë në 2002/3 dhe 0.7 € në 2005 konsumi i përgjithshëm vjetor ka qenë 56 milion € në 2005 dhe 71 milion € në 2002/3. Përqindja e duhanxhinjve është zvogëluar për 4 përqind si tek meshkujt ashtu edhe te femrat. Një e treta e meshkujve ende pinë duhan. Femrat e të gjitha moshave pinë më pak duhan se përpara, si dhe meshkujt e moshës më të re se 29 vjet. Meshkujt në moshë nuk pinë më pak duhan.

Figura 9 Konsumi i alkoolit dhe duhanit sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimt 2003-2005, €





Tabela 1 Përqindja e duhanxhinjve në popullatë sipas gjinisë konsumit ditor të cigareve, % e popullatës në moshën 16 vjet dhe më të moshuar

	Meshkujt		Femrat		All	
	2002	2005	2002	2005	2002	2005
1-10	2%	2%	2%	2%	2%	2%
11-20	20%	22%	5%	3%	13%	12%
21+	14%	8%	2%	0%	8%	3%
Nr. përgj. i duhanxhinjve	36%	32%	9%	5%	22%	18%

Shëndetësia

Shpenzimet për shëndetësi janë rritur mjaftë shumë. Ato përbëjnë më shumë se trefishin për njerëzit më arsimim të lartë. Ndryshimet ndërmjet grupeve janë të vogla.


Figura 10 Shpenzimet për shëndetësi sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



Komunikimi

Shpenzimet për komunikim gjithashtu janë rritur mjaftë shumë gjatë këtyre tri viteve. Ekonomitë familjare urbane dhe ato me shkollim të lartë bëjnë shumë më tepër shpenzime se të tjerët.


Figura 11 Komunikimi sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



Rekreacioni

Shpenzimet për rekreacion dhe kulturë kanë trend të përzier. Kulm i shpenzimeve për të gjitha ekonomitë familjare ka qenë në vitin 2004. Vetëm ekonomitë familjare urbane kanë shpenzuar shumë më tepër për rekreacion në vitin 2005 se në 2004. Kjo pasqyrë aludon se familjet me arsim të lartë kanë pasur një ekonomi më të keqe në vitin 2005 krahasuar me 2004.


Figura 12 Shpenzimet për rekreacion sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



Arsimi

Edhe shpenzimet për arsim gjithashtu kanë arritur kulmin në vitin 2004 dhe ekonomitë familjare me arsim të lartë kanë shpenzuar më shumë se dyfishin krahasuar me grupet tjera.


Figura 13 Shpenzimet për arsim sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



Hotele dhe restorante

Shpenzimet për hotele dhe restorante kanë pasur parametra të njëjtë me rekreacionin si gjatë kohës ashtu edhe ndërmjet grupeve.


Figura 14 Shpenzimet për hotele dhe restorante sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



Të përziera

Ky grup është një përzierje e mallrave për parukeri, mallrave për nevoja personale dhe shpenzime për sigurime dhe shpenzime tjera financiare. Ato janë rritur mjaftë shumë për të gjitha grupet e ekonomive familjare.

Figura 15 Shpenzimet tjera sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2005, €



Konkluzion

Ekonomia familjare kosovare ngadalë po transformohet nga dominimi i ushqimit në banim, veshmbathje dhe transport. Ekonomitë familjare urbane dhe ato me arsim të lartë janë më përpara në këtë aspekt dhe po e rrisin pjesën e buxhetit për komunikim, arsim, rekreacion dhe hotele e restorante.

Tabela 2 Konsumi vjetor i ekonomive familjare në Kosovë 2003-2005 sipas grupeve kryesore të konsumit, lokalitetit dhe arsimit i kryefamiljarëve të ekonomive familjare, € dhe % konsumit të përgjithshëm

Kosova	Ekonomitë familjare	Ushqimi	Alko & duhan	Veshmb	Banim	Furnizim	Shend	Transp	Komp	Rekre	Arsim	Hotel & rest	Te tjera	Totali
2003	278 397	2 484 €	178 €	257 €	1 536 €	211 €	79 €	223 €	69 €	62 €	37 €	53 €	91 €	5 281 €
2004	274 371	2 320 €	176 €	307 €	1 806 €	128 €	122 €	274 €	91 €	77 €	82 €	64 €	116 €	5 563 €
2005	261 877	2 274 €	229 €	337 €	1 834 €	237 €	133 €	353 €	123 €	70 €	42 €	70 €	162 €	5 863 €
Urbane														
2003	94 332	2 249 €	189 €	233 €	2 060 €	219 €	77 €	189 €	122 €	78 €	20 €	78 €	107 €	5 621 €
2004	105 308	2 246 €	174 €	285 €	2 254 €	123 €	107 €	235 €	134 €	89 €	96 €	91 €	112 €	5 946 €
2005	105 120	2 121 €	216 €	354 €	2 384 €	225 €	128 €	341 €	162 €	120 €	57 €	104 €	186 €	6 399 €
Rurale														
2003	184 065	2 605 €	173 €	270 €	1 268 €	207 €	79 €	241 €	42 €	54 €	46 €	40 €	83 €	5 107 €
2004	168 964	2 366 €	177 €	320 €	1 528 €	131 €	132 €	298 €	65 €	70 €	73 €	47 €	119 €	5 326 €
2005	156 546	2 378 €	237 €	325 €	1 463 €	245 €	136 €	361 €	96 €	36 €	32 €	48 €	147 €	5 503 €
Arsim fillor apo me pak														
2003	131 599	2 454 €	185 €	235 €	1 323 €	198 €	85 €	207 €	48 €	49 €	32 €	28 €	83 €	4 927 €
2004	126 789	2 220 €	186 €	265 €	1 480 €	90 €	132 €	221 €	65 €	46 €	47 €	34 €	91 €	4 877 €
2005	115 943	2 274 €	243 €	277 €	1 506 €	216 €	134 €	301 €	99 €	22 €	33 €	44 €	151 €	5 300 €
Arsim të mesëm														
2003	108 976	2 451 €	168 €	254 €	1 576 €	207 €	74 €	214 €	71 €	66 €	38 €	44 €	90 €	5 252 €
2004	110 942	2 310 €	164 €	301 €	1 913 €	146 €	108 €	276 €	95 €	66 €	81 €	59 €	120 €	5 637 €
2005	104 725	2 210 €	221 €	328 €	1 858 €	235 €	122 €	335 €	124 €	74 €	42 €	66 €	151 €	5 766 €
Arsim të lartë														
2003	36 873	2 669 €	184 €	345 €	2 176 €	271 €	68 €	310 €	136 €	102 €	54 €	164 €	127 €	6 605 €
2004	36 455	2 695 €	175 €	469 €	2 621 €	208 €	133 €	454 €	169 €	221 €	208 €	181 €	192 €	7 728 €
2005	41 209	2 437 €	209 €	530 €	2 693 €	300 €	159 €	541 €	187 €	191 €	66 €	156 €	222 €	7 692 €

Kosova	Ekonomitë familjare	Ushqimi	Alko & duhan	Veshmb	Banim	Furnizim	Shend	Transp	Komp	Rekre	Arsim	Hotel & rest	Te tjera	5 i madh
2003	278 397	47%	3%	5%	29%	4%	1%	4%	1%	1%	1%	1%	2%	89%
2004	274 371	42%	3%	6%	32%	2%	2%	5%	2%	1%	1%	1%	2%	87%
2005	261 877	39%	4%	6%	31%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	1%	3%	86%
Urbane														
2003	94 332	40%	3%	4%	37%	4%	1%	3%	2%	1%	0%	1%	2%	88%
2004	105 308	38%	3%	5%	38%	2%	2%	4%	2%	1%	2%	2%	2%	86%
2005	105 120	33%	3%	6%	37%	4%	2%	5%	3%	2%	1%	2%	3%	85%
Rural														
2003	184 065	51%	3%	5%	25%	4%	2%	5%	1%	1%	1%	1%	2%	90%
2004	168 964	44%	3%	6%	29%	2%	2%	6%	1%	1%	1%	1%	2%	87%
2005	156 546	43%	4%	6%	27%	4%	2%	7%	2%	1%	1%	1%	3%	87%
Arsim fillor apo më pak														
2003	131 599	50%	4%	5%	27%	4%	2%	4%	1%	1%	1%	1%	2%	90%
2004	126 789	46%	4%	5%	30%	2%	3%	5%	1%	1%	1%	1%	2%	88%
2005	115 943	43%	5%	5%	28%	4%	3%	6%	2%	0%	1%	1%	3%	86%
Të mesëm														
2003	108 976	47%	3%	5%	30%	4%	1%	4%	1%	1%	1%	1%	2%	90%
2004	110 942	41%	3%	5%	34%	3%	2%	5%	2%	1%	1%	1%	2%	88%
2005	104 725	38%	4%	6%	32%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	1%	3%	86%
Të lartë														
2003	36 873	40%	3%	5%	33%	4%	1%	5%	2%	2%	1%	2%	2%	87%
2004	36 455	35%	2%	6%	34%	3%	2%	6%	2%	3%	3%	2%	2%	83%
2005	41 209	32%	3%	7%	35%	4%	2%	7%	2%	2%	1%	2%	3%	85%

Ne ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij publikimi për bashkëpunim, dhe ju lutemi që për komentet dhe syzjerimet tuaja, të kontaktoni Departamentin e Statistikave Sociale, përkatësisht Sektorin e Standardit Jetësorë përmes telefonit: 038/235 148, 038 235 136 ose përmes adresës: social@ks-gov.net dhe vizitoni vebfaqen tonë: www.ks-gov.net/esk